



## REPUBLIKA E SHQIPERISË

### Komisioni i Dhënive të Medaljeve dhe Titujve Vendorë të Nderit

Nr. 9604 prot.

Gramsh, më 22 / 11 /2023

### RAPORT

**LËNDA:** Për miratimin e Raportit të Komisionit të Dhënive të Medaljeve dhe Titujve Vendorë të Nderit.

**DREJTUAR:** Këshillit Bashkiak Gramsh

**BAZA LIGJORE:** Ligji 139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji nr.9270/2004 për “Sistemin e Adresave”, Ligji 112/2013 për “Dhënien e Dekoratave, Titujve të Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendore të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.109/2018 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”, VKM nr.861/2014, Rregullorja e Funkcionimit të Këshillit Bashkiak.

Bazuar në thirrjen Nr.Prot.3984 datë 13/10/2023 drejtuar Komisionit, lidhur me kërkesën Nr.Regj.325 datë 22/08/2023 nga Komiteti I Veteranëve e Pasardhësve të Lanc, të Bashkisë Gramsh, u administruan dokumentat bashkëngjitur kërkesës dhe u mbledh Komisioni, i cili doli me Raportin si më poshtë vijon:

### RAPORT

Komisioni Këshillimor për Dhënien e Titujve Vendorë të Nderit i përbërë nga anëtarët: Albert Ceci Kryetar, Kodhel Cala Sekretar, Luljeta Dollani Anetar, Leidi Shqiponja Anetar, Sali Zani Anetar, u mbledh më datë 17/11/2023 ora 10:00 ku vazhdoj me procedurat e shqyrtimit të propozimeve sipas kritereve dhe legjislacionit në fuqi.

Në vijim të punës së Komisionit pasi u administrua i gjithë dokumentacioni i kërkuar sot më datë 17/11/2023 në sallën kati II Pallati I Kulturës, u vërejt se dosja është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi (referoju proces-verbalit të mbledhjes së Komisionit), duke i shqyrtuar kërkesë/propozimet në mënyrë individuale për çdo subjekt të paraqitur për vlerësim sipas propozimeve më poshtë:

Për dy rastet : **Hasan Qamil Kumria dhe Veiz Jonuz Hasa**, Komisioni shpreh dakortësinë për të pranuar propozimin duke qënë se është gjetur zgjidhja sa i përket përcaktimit të vendit ku do bëhet emërtimi i rrugës (i shpjeguar në hartën bashkëngjitur), gjithashtu për këto raste ka konsensus edhe me komunitetin. Dosjet e të dy rasteve të propozuara janë të plota, konflikte nuk ka dhe rrugët të cilat propozohen tu vihet emërtimi janë të pa emërtuara më parë.

Sa i përket rastit të tretë të propozuar : **Sabri Abaz Lumshi**, Komisioni vëren një problematikë, e cila konsiston në faktin se, për këtë rast kërkohet të hiqet emërtimi i vënë më parë dhe të vihet i ri sipas këtij propozimi. Komisioni nuk shpreh dakortësi për prishjen e vendimeve të mëparshme pasi kjo mund të bëhet precedent më vonë për raste të tjera. Për këtë rast do të vazhohen diskutimet për tu gjetur zgjidhja e duhur, në bashkëbisedim edhe me sektorin e urbanistikës ,së bashku me propozuesin do të shohim për zgjidhje në vazhdim.

Në përfundim të diskutimeve, komisioni shpreh dakortësinë të pranojë dy propozimet e para :  
**1-Hasan Qamil Kumria dhe 2-Veiz Jonuz Hasa.**

Sa i përket propozimit për **Sabri Abaz Lumshi** do të vazhdojmë të diskutojmë për të gjetur zgjidhjen e duhur pa cënuar asnjë vendim të mëparshëm.

**Kryetari i Komisionit të Mandateve**

**Albert Ceci**

**Sekretari i Komisionit të Mandateve**

**Kodhel Çala**

**Anëtar i Komisionit**

**Luljeta Dollani**

**Anëtar i Komisionit**

**Leidi Shqiponja**

**Anëtar i Komiosionit**

**Sali Zani**